



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

NJOFTIM – ZGJEDHJET E STUDENTËVE 2017

Në zbatim të Statutit të Përkohshëm dhe Rregullores për Zgjedhjet e Studentëve, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2017, ka marrë vendim mbi shpalljen e zgjedhjeve të studentëve të Universitetit, të cilat do të mbahen më **24.04.2017**.

Universiteti i Mitrovicës inkurajon të gjithë studentët e universitetit, që të marrin pjesë në zgjedhje dhe të votojnë kandidatët, që ata mendojnë, se më së miri do t'i përfaqësojnë interesat e tyre në njësitë akademike përkatëse dhe në Senatin e Universitetit.

Universiteti inkurajon kandidimin e studentëve më të mirë dhe të gjitha Organizatat Studentore (OS) të cilat në programet e tyre nuk kanë agjendë politike, fetare dhe racore, që denjësisht t'i përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve.

Organizatrat studentore, të interesuara për të marr pjesë në zgjedhjet studentore, për Këshilla të studentëve të fakulteteve dhe për Parlament të studentëve, do të certifikohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor me datë **10.04.2017**. Paraprakisht, OS duhet të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike, konform Ligjit për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. Me rastin e aplikimit për certifikim në KQZ, organizatat studentore duhet të dorëzojnë edhe Listën e deklarimit të studentëve, në mbështetje për certifikimin e Organizatës studentore për zgjedhjet e studentëve 2017, me më së paku 50 nënshkrime, për certifikim për zgjedhjet për Këshill të studentëve dhe me më së paku 150 nënshkrime, për certifikim për zgjedhjet për Parlament të studentëve.

Për informata më të hollësishme lidhur me mbarevajtjen e procesit zgjedhor klikoni linkun [zgjedhjetstudentore2017](#)

